



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË 2024 - 2025

Prishtinë, Mars 2026

Përmbajtja

Tabela e shkurtesave	3
1. Hyrje	6
2. Baza Ligjore	7
3. Qasja e vlerësimit të konkurrencës së tregut	9
1.1. Përqindja e tregut, raporti i përqendrimit dhe indekset HHI	9
1.2. Indeksi i Prodhuesit Pivotal (Pivotal Supplier Index – PSI)	10
1.3. Indeksi i Furnizimit të Mbetur (Residual Supply Index – RSI)	12
4. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me shumicë të energjisë elektrike	12
4.1. Përshkrimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë	12
Marrëveshja e furnizimit me shumicë ndërmjet KEK dhe furnizuesit të shërbimit universal	14
4.2. Llogaritja e indekseve për tregun me shumicë në Kosovë	15
Përqindja e Tregut	15
Indeksi HHI	16
Indeksi i Prodhuesit Pivotal (Pivotal Supplier Index – PSI)	17
Indeksi i Furnizimit të Mbetur (Residual Supply Index – RSI)	18
5. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me pakicë të energjisë elektrike	19
5.1. Përshkrimi i tregut me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë	19
Furnizuesi i Mundësisë së Fundit	20
5.2. Llogaritja e indekseve për tregun me pakicë në Kosovë	21
Pjesëmarrja në treg dhe indeksi HHI	21
6. Përfundime	23
Shtojca 1. Ndikimi i bashkimit të tregut me Shqipërinë në konkurrencën e tregut me shumicë të energjisë elektrike	26

Tabela e shkurtesave

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument kanë këtë kuptim:

ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë
RP	Raporti i Përqendrimit
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
PPE	Prodhuesi i Pavarur i Energjisë
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
HC	Hidrocentrali
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KEK	Korporata Energjetike e Kosova
KESCO	Kompania Kosovare e Furnizimit të Energjisë Elektrike
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
MW	Megavat
PSi	Indeksi i Prodhuesit Pivotal
RSI	Indeksi i furnizuesit të mbetur
FMF	Furnizuesi i Mundësisë së Fundit
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
FSHU	Furnizuesi i Shërbimit Universal
PE	Parku i Erës
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, duke analizuar segmentet e tregut me shumicë dhe tregut me pakicë për periudhën 2024–2025. Analiza bazohet në vlerësimin e strukturës së tregut dhe në përdorimin e indikatorëve standardë të konkurrencës, përfshirë përqindjen e tregut, raportet e përqendrimit, indeksin Herfindahl–Hirschman (HHI), Indeksin e Prodhuesit Pivotal (PSI) dhe Indeksin e Furnizimit të Mbetur (RSI).

Mandati i Zyrës së Rregullatorit për Energji për monitorimin e konkurrencës në sektorin e energjisë buron nga Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullatori, në bashkëpunim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Zyrën e Ndhmës Shtetërore, është i obliguar të kryejë së paku një herë në dy vjet vlerësimin e funksionimit të tregut të energjisë elektrike.

Tregu me shumicë i energjisë elektrike

Struktura e tregut me shumicë në Kosovë karakterizohet nga një përqendrim i lartë i prodhimit vendor. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike të prodhuar në vend prodhohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Një pjesë e konsiderueshme e kësaj energjie furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal, ndërsa pjesa tjetër përdoret për mbulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe për eksport në tregjet rajonale.

Indeksi i Furnizuesit Kryesor (PSI) tregon se gjatë të gjitha orëve KEK-u konsiderohet si thelbësor (i nevojshëm për të zëvendësuar importet), ndërsa HC Ujmani konsiderohet si thelbësor (i nevojshëm për shmangien e importit) në 57% të orëve në vitin 2024 dhe 79% të orëve në vitin 2025, edhe pse kishte një përqindje tregu prej vetëm 1.03% dhe 1.29 % përkatësisht. Indeksi i Furnizimit të Mbetur (RSI) tregon se KEK-u ka një shkallë të lartë të fuqisë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit. HC Ujmani mund të ushtrojë fuqi të kufizuar në treg për shkak të prodhimit të kufizuar.

Tregu me pakicë i energjisë elektrike

Në tregun me pakicë në Kosovë janë të licencuar 30 furnizues, megjithatë vetëm një numër i kufizuar 8 prej tyre janë aktiv në treg. Furnizimi me shumicën e konsumatorëve realizohet përmes Furnizuesit të Shërbimit Universal.

Gjatë periudhës së analizuar, shumica e konsumatorëve vazhdojnë të furnizohen me tarifa të rregulluara, ndërsa numri i konsumatorëve që kanë kaluar në furnizim me çmime të tregut mbetet shumë i ulët. Kjo reflekton një nivel të kufizuar të liberalizimit efektiv të tregut dhe një nivel të lartë përqendrimi në segmentin e furnizimit me energji elektrike në tregun me pakicë. Megjithatë, gjatë vitit të kaluar është shënuar një ndryshim i rëndësishëm në sektorin e energjisë elektrike ku një pjesë e konsumatorëve komercial kanë kaluar në furnizim në tregun e hapur, si pjesë e procesit të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike

Bazuar në indikatorët e analizuar, tregu me pakicë karakterizohet nga një nivel i lartë përqendrimi dhe konkurrencë e kufizuar.

Për periudhën e shqyrtimit, bazuar në treguesit e analizuar, tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë shfaq mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë në treg.

Rezultatet e analizës tregojnë si në tregun me shumicë ashtu edhe në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë ekziston një nivel i lartë përqendrimi. Struktura aktuale e tregut dhe numri i pjesëmarrësve aktivë kufizon zhvillimin e konkurrencës efektive.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut konkurrues kërkon avancimin e procesit të liberalizimit të furnizimit, rritjen e pjesëmarrjes së prodhuesve të rinj në treg dhe integrimin më të thellë me tregjet rajonale të energjisë.

1. Hyrje

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë ka kaluar një proces të vazhdueshëm reformash gjatë dy dekadave të fundit, duke kaluar nga një strukturë vertikalisht e integruar drejt një modeli të ndarë institucional dhe funksional të aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

Këto reforma janë ndërmarrë me qëllim krijimin e një tregu të hapur dhe konkurrues të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me obligimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Në këtë proces, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka rol qendror në monitorimin e funksionimit të tregut dhe në ndërmarrjen e masave të nevojshme për të nxitur konkurrencën dhe për të siguruar funksionimin efikas të sektorit.

ZRRE synon të krijojë konkurrencë në segmentet e tregut që nuk janë monopole natyrore, si në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike. Një treg konkurrues siguron shpërndarje efikase të burimeve ndërmjet pjesmarrësve të tregut. Vlerësimi i konkurrencës ofron një analizë të thellë të funksionimit të tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në Kosovë, për më tepër, raporti vlerëson nivelin aktual të konkurrencës në segmentet e prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike në Kosovë dhe e krahason atë me vitet e mëparshme.

Ky raport paraqet një vlerësim të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, duke analizuar strukturën dhe funksionimin e tregut me shumicë dhe tregut me pakicë. Analiza bazohet në përdorimin e indikatorëve të ndryshëm të konkurrencës, si përqindja e tregut, raportet e përqendrimit, indeksi Herfindahl–Hirschman (HHI), Indeksi i Prodhuesit Pivotal (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit të Mbetur (RSI).

Raporti mbështetet në të dhëna për periudhën 2024–2025, si dhe në të dhëna historike për të mundësuar krahasimin e zhvillimeve në treg gjatë viteve të fundit. Qëllimi i këtij vlerësimi është identifikimi i nivelit aktual të konkurrencës në treg dhe i faktorëve strukturorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e konkurrencës efektive në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë.

2. Baza Ligjore

ZRRE është agjenci e pavarur, e ndarë ligjërisht dhe funksionalisht nga çdo person tjetër fizik ose juridik. Detyrat dhe funksionet e ZRRE-së janë të përcaktuara në Ligjin nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili ndër të tjera përfshinë: krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, krijimin dhe funksionimin e tregjeve efikase, transparente dhe jo diskriminuese të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve si dhe dhënien e licencave për kryerjen e veprimtarive në sektorin e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimin e tregut dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme bazuar në metodologjinë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës mbizotëruese dhe praktikave jo konkurruese nga sipërmarrjet energjetike, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë.

Neni 15.1, nën-paragrafi 1.2, i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ndër të tjera, përcakton përgjegjësinë për vlerësimin e funksionimit të tregut dhe konkurrencës, i cili thotë: për të përmbushur detyrat e veta, ZRRE ka autoritetin dhe përgjegjësinë si në vijim:

“1.2. të përkujdeset për funksionim transparent dhe jo diskriminues të tregjeve të energjisë, duke u bazuar në parimet e tregut të lirë, sa u përket aktiviteteve konkurruese dhe aktiviteteve të rregulluara;”

Bazuar në të drejtat e parapara me nenin 24.1 të Ligjit për Energjinë, ZRRE-ja zbaton masa që synojnë parandalimin e shkeljeve të dispozitave të Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë, nenet 22 dhe 23, të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e kufizimeve të konkurrencës, përkatësisht duke ndaluar keqpërdorimin e pozitës mbizotëruese në treg.

Ndërsa, sipas Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, neni 26, ndër të tjera parashihet si në vijim:

“1. Rregullatori, në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe me Zyrën e Ndhmës Shtetërore, së paku çdo dy (2) vite duhet të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.”

“2. Rregullatori mund të përcaktojë masa të nevojshme dhe proporcionale të obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut të energjisë elektrike. Këto masa mund të përfshijnë programet për ofrimin në treg të sasive të caktuara të energjisë elektrike, sipas të cilit subjektet obligohen të shesin ose të vënë në dispozim sasi të caktuara të energjisë elektrike ose mundësimin e qasjes në një pjesë të kapaciteteve të tyre prodhuese, furnizuesve të interesuar, për një periudhë kohore të caktuar.”

Ndërsa Ligji për Energjinë, përkatësisht neni 24, i përcakton kompetencat e ZRRE-së dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës sa i përket konkurrencës, si në vijim:

“2. Nëse Rregullatori mbledh dëshmi të arsyeshme mbi një shkelje aktuale ose të dyshuar sipas dispozitave të nenit 22 dhe 23 të këtij ligji nga një ndërmarrje e energjisë, Rregullatori i dorëzon këto dëshmi në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës inicion një hetim të shkeljes së pohuar dhe merr çfarëdo masa zbatuese të cilat i konsideron të

nevojshme dhe të përshtatshme për korrigjimin ose adresimin e shkeljes së pohuar në përputhje me Ligjin për Konkurrencën.”

“3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kryen një hetim, qoftë në bazë të informatave të marra nga Rregullatori ose nga çfarëdo burimi tjetër, përfshirë edhe me veprime të veta, mbi një shkelje të pohuar ose potenciale nga një ndërmarrje e energjisë të Ligjit për Konkurrencën sipas nenit 22 apo 23 të këtij ligji, Rregullatori do të ndihmoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në kryerjen e këtij hetimi dhe vlerësimin e shkeljes së pohuar.”

Sipas nenit 15.7, nën-paragrafi 7.3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, është detyrë e ZRRE-së që të bashkëpunojë me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për të siguruar:

“7.3. se krijohet dhe mirëmbahet tregu konkurrues, aty ku është e mundshme, si dhe t’i pengojë e t’i dënojë veprimet kundër konkurrese, në bashkëpunim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës;”

ZRRE-ja dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në shtator 2020, siç kërkohet me nenin 24.1 të Ligjit për Energjinë, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe ranë dakord për të përcaktuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet dy institucioneve që kanë të bëjnë me monitorimin e konkurrencës në tregun e energjisë.

3. Qasja e vlerësimit të konkurrencës së tregut

Vlerësimi i konkurrencës në tregjet e energjisë elektrike kërkon përdorimin e një kombinimi të indikatorëve strukturorë dhe analitikë që mundësojnë identifikimin e përqendrimit të tregut dhe potencialit për ushtrim të fuqisë së tregut nga aktorët kryesorë.

Në këtë raport janë përdorur disa nga indikatorët më të njohur në analizën e konkurrencës në tregun me shumicë, përfshirë përqindjen e tregut, indeksin Herfindahl-Hirschman (HHI), si dhe indikatorë më specifikë për tregjet e energjisë si Indeksi i Prodhuesit Pivotal (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit të Mbetur (RSI).

Ndërsa për tregun me pakicë janë analizuar indekset e mëposhtme:

- Përqindja e tregut
- Raporti i përqendrimit (CR_3)
- Indeksi HHI

Analiza është kryer duke përdorur të gjithë indekset që janë llogaritur duke u bazuar në të dhëna orë për orë të vitit 2024 dhe 2025.

1.1. Përqindja e tregut, raporti i përqendrimit dhe indekset HHI

Përqindja e tregut, raportet e përqendrimit dhe indekset HHI janë metodat më të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për të vlerësuar konkurrencën në tregje. Ideja prapa përdorimit të këtyre indekseve është se një treg më i përqendruar çon në më pak konkurrencë dhe gjasë të shtuar që pjesëmarrësit me përqindje të lartë tregu të ushtrojnë fuqi të tregut.

Për këto indekse është e rëndësishme të përcaktohet produkti dhe rajoni gjeografik. Në tregjet me shumicë të energjisë elektrike, produkti mund të përfshijë prodhimin e energjisë, energjinë plus rezervat, kapacitetet afatshkurta dhe kapacitetet afatgjata¹. Për qëllime të këtij raporti ZRRE konsideronë se produkti është i kufizuar në vëllimet e prodhimit të energjisë. Sa i përket rajonit gjeografik, konsiderohen vetëm gjeneratorët aktiv brenda territorit të Kosovës, si dhe nuk supozohen çështje të rëndësishme të kongestionit brenda kufijve të vendit.

Për të analizuar tregun me pakicë, ne kemi marrë parasysh 2 parametra të ndryshme: 1) numrin e konsumatorëve me pakicë të shërbyer nga një furnizues; dhe 2) vëllimin e energjisë elektrike të shërbyer nga një furnizues.

Pjesëmarrja në treg e një kompanie përcaktohet si përqindja e tregut që shërbehet nga kompania. Në rastin e tregut me shumicë, ajo është raporti ndërmjet energjisë së prodhuar nga kompania dhe totalit të energjisë së prodhuar në vend. Ndërsa, për tregun me pakicë përkufizohet si raporti ndërmjet numrit/energjisë së konsumatorëve të shërbyer dhe numrit total/energjisë së konsumatorëve me

¹ Twomey, P. & Green, R. & Neuhoﬀ, K. & Newbery, D. (2005): A Review of the Monitoring of Market Power The Possible Roles of TSOs in Monitoring for Market Power Issues in Congested Transmission Systems

pakicë. Për shembull, një kompani që prodhon 10 MWh/vit energji elektrike në një treg prej 100 MWh/vit, ka një përqindje tregu prej 10%.

Përqindja e tregut në disa raste mund të jep rezultate çorientuese. Në rastin e përqindjes së tregut, një kompani me një përqindje tregu prej 25% në një treg shumë të segmentuar ka një fuqi tregu më të lartë se një kompani me një përqindje tregu 25%, e cila është vetëm kompania e dytë ose e tretë më e madhe në treg.

Për të trajtuar këtë çështje, Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) është llogaritur për të vlerësuar përqendrimin e tregut. HHI llogaritet duke ngritur në katror Përqindjet e Tregut (PT) të të gjitha kompanive dhe duke mbledhur vlerat e fituara pas ngritjes në katror².

$$HHI = \sum_{i=1}^n (PT_i)^2$$

Vlerat e indeksit HHI mund të arrijnë deri në 10,000, në rastet kur një kompani e vetme kontrollon 100% të tregut. Sa më i lartë të jetë indeksi HHI, aq më i lartë është përqendrimi i tregut. Një indeks HHI afër 10,000 është tregues i një strukture monopoliste, ndërsa vlerat afër 0 tregojnë konkurrencë të përsosur.

Derisa nuk ka kufij të caktuar për vlerat HHI, në përgjithësi pragu i vlerave sillet si më poshtë³:

- HHI < 1,500 – tregon treg me konkurrencë të lartë
- 1,500 ≤ HHI < 2,500 – tregon treg me përqendrim mesatar
- 2,500 ≤ HHI – tregon treg me përqendrim të lartë

Një kritikë e zakonshme ndaj indeksit HHI për tregjet me shumicë të energjisë elektrike është se ai është një indeks statik, i cili nuk merr parasysh nevojat e kërkesës dhe ofertës orë për orë. Një kompani mund të ketë një përqindje të tregut të prodhimit prej 20%, megjithatë modeli i saj i ofertës nuk përputhet me modelin e konsumit, dhe kështu kjo kompani është një marrëse e çmimeve. Nga ana tjetër, kur kapacitetet e prodhimit të sistemeve janë afër kufirit të kërkesës, një kompani mund të ushtrojë fuqinë e tregut dhe të bëhet një “prodhues pivotal” edhe me përqindje të ulëta të tregut. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë ndërprerjeve të prodhimit, orëve të kërkesës së lartë, etj. Për të kapërcyer këto kufizime përdoren Indeksi i Prodhuarit Pivotal (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit të Mbetur (RSI).

1.2. Indeksi i Prodhuarit Pivotal (Pivotal Supplier Index – PSI)

Në tregjet e energjisë elektrike, gjatë mungesës së energjisë për shkak të rënieve të prodhuesve të energjisë elektrike, ose gjatë kërkesës maksimale, edhe prodhuesit e energjisë elektrike me përqindje të ulëta të tregut mund të ushtrojnë fuqi të tregut.

² Rhoades, S. A. (1993). Herfindahl-Hirschman Index, The. Fed. Res. Bull., 79, 188.

³ Beus, M., Pavić, I., Štritof, I., Capuder, T. and Pandžić, H., 2018. Electricity Market Design in Croatia within the European Electricity Market—Recommendations for Further Development. Energies, 11(2), p.346.

Indeksi i Prodhuesit Pivotal (PSI) përfshin përveç kërkesës edhe ofertën, për të matur fuqinë potenciale të tregut të pjesëmarrësve në treg. PSI-ja synon të tregojë nëse dhe sa shpesh një prodhues konsiderohet i domosdoshëm për të mbuluar kërkesën. PSI-ja mat se sa shpesh kapaciteti i një prodhuesi është më i madh se oferta e tepërt (diferenca ndërmjet ofertës totale dhe kërkesës).

Në këtë raport, PSI-ja kufizohet në prodhimin vendor dhe nuk përfshin kapacitetet e importit. Me fjalë të tjera, PSI-ja mat se sa shpesh nevojitet një prodhues për të siguruar që e gjithë energjia të prodhohet në vend dhe sa shpesh mund të ushtrrojë fuqinë e tregut për të rritur çmimet, deri në çmimet e importit. PSI-ja llogaritet për çdo orë dhe është një indeks binar.

Një prodhues konsiderohet se ishte pivotal (PSI = 1) nëse një orë kërkesa tejkalon kapacitetin e kombinuar të të gjithë prodhuesve të tjerë në sistem⁴.

$$PSI_{i,t} = \begin{cases} 1, & \text{if } D_t \geq \sum_{i \neq j} C_{j,t} \\ 0, & \text{if } D_t < \sum_{i \neq j} C_{j,t} \end{cases}$$

$$D_t = \text{Gjithsej kërkesa} - \text{Energjia e domosdoshme} \\ = TD_t - E_{Kitka,t} - E_{Selaci,t} - E_{Lumbardhi,t} - E_{dist,t}$$

Ku:

i – kompania prodhuese për të cilën e llogarisim PSI-në

j – të gjitha kompanitë e tjera prodhuesve

D_t – Kërkesa në kohën “t” (MW)

C – Kapaciteti në dispozicion (MW)

TD_t – Gjithsej kërkesa në kohën “t” (MW)

$E_{Kitka,t}$ – Kapaciteti prodhues nga PE Kitka në kohën “t” (MW)

$E_{Selaci,t}$ – Kapaciteti prodhues nga PE Selaci në kohën “t” (MW)

$E_{Lumbardhi,t}$ – Kapaciteti prodhues nga HC Lumbardhi në kohën “t” (MW)

$E_{dist,t}$ – Kapaciteti prodhues i gjeneratorëve të kyçur në distribucion në kohën “t” (MW)

Kërkesa konsiderohet si kërkesa e mbetur, ose kërkesa totale në nivel transmetimi, e zbritur nga energjia e prodhuar nga era (PE Kitka dhe PE Selaci), dielli dhe gjeneratorët me rrjedh (HC Lumbardhi). Energjia nga këta gjeneratorë konsiderohet se “duhet marrë” në Kosovë dhe kapacitetet e tyre nuk mund të planifikohen apo kursehen për kushte më të përshtatshme tregu.

Për të siguruar ndërprerjet dhe kapacitetet teknike të KEK-ut, kapaciteti i disponueshëm në kohën “t” konsiderohet si energjia e prodhuar nga KEK-u, në atë orë (MWh/h), ndërsa kapaciteti nga HC Ujmani si kapaciteti neto i HC Ujmani (32 MW).

⁴ Biggar, D. 2011. The theory and practice of the exercise of market power in the Australian NEM.

1.3. Indeksi i Furnizimit të Mbetur (Residual Supply Index – RSI)

Derisa Indeksi i Prodhuesit Pivotal (PSI) është një indeks binar, i cili mat kur dhe nëse një prodhues është i domosdoshëm, Indeksi i Furnizimit të Mbetur mat shtrirjen e "domosdoshmërisë" së kompanive. Indeksi mat se deri në çfarë mase prodhuesit e tjerë në treg mund të mbulojnë kërkesën, pa kapacitetin e kompanisë.⁵

RSI-ja llogaritet me anë të formulës në vijim:

$$RSI_{it} = \frac{\text{gjithsej kapaciteti në dispozicion} - \text{kapaciteti}_i}{\text{kërkesa e tregut}}$$

Për të llogaritur RSI-në duhet të merren parasysh disa faktorë. Gjithsej kapaciteti i disponueshëm është shuma e energjisë së prodhuar në orë nga PE Kitka, PE Selaci, HC Lumbardhi, gjeneratorët në distribucion, KEK, si dhe kapaciteti prodhues i HC Ujmanit. Meqenëse kapaciteti në dispozicion duhet të marrë parasysh edhe ndërprerjet e prodhimit dhe kufizimet teknike, për termocentralet e KEK-ut, kapaciteti në dispozicion konsiderohet si energjia e dhënë në kohën "t" në orë (MWh/h). Ndërsa kapaciteti nga HC Ujmani konsiderohet si kapaciteti neto i HC Ujmani (32 MW).

Kërkesa e tregut konsiderohet si kërkesa totale për energji elektrike në nivel transmetimi.

Nëse një prodhues ka një vlerë RSI prej >100% në një kohë të caktuar, kjo do të thotë se në atë kohë, prodhuesit tjerë mund të furnizojnë të gjithë energjinë elektrike të nevojshme për të mbuluar kërkesën, kështu që ky prodhues nuk konsiderohet pivotale (PSI = 0); ajo mund të ushtrojë fuqi të kufizuar në treg dhe ka pak ndikim në çmimin e tregut. Në mënyrë të ngjashme, nëse një prodhues ka një RSI prej <100%, prodhuesit tjerë nuk mund të ofrojnë energjinë e nevojshme elektrike për të mbuluar kërkesën. Sa më i ulët të jetë RSI për atë prodhues, aq më shumë mund të ushtrojë fuqi në treg dhe anasjelltas.

Vlerat RSI do të paraqiten me një lakore kohëzgjatjeje.

4. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me shumicë të energjisë elektrike

1.4. Përshkrimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë

Analiza e konkurrencës në tregun me shumicë është bazuar në vlerësimin e pjesëve të tregut të prodhuesve, si dhe në përdorimin e indikatorëve PSI dhe RSI për të identifikuar potencialin për ushtrimin e fuqisë së tregut. Tregu me shumicë i energjisë elektrike në Kosovë karakterizohet nga një nivel i lartë përqendrimi, ku prodhimi i energjisë dominohet nga një prodhues kryesor. Struktura

⁵ Bataille, M., Steinmetz, A. and Thorwarth, S., 2014. Screening Instruments for Monitoring Market Power in Wholesale Electricity Markets Lessons from Applications in Germany. SSRN Electronic Journal.

aktuale e prodhimit reflekton historinë e zhvillimit të sektorit energjetik në Kosovë, ku prodhimi është bazuar kryesisht në termocentralet me linjit.


Në këtë kuptim, pjesa më e madhe e energjisë elektrike në vend prodhohet nga termocentralet e KEK-ut, ndërsa kontributi i prodhuesve të tjerë, përfshirë burimet e ripërtëritshme dhe hidrocentralet, mbetet relativisht i kufizuar.

Një karakteristikë e rëndësishme e tregut është fakti se pjesa më e madhe e energjisë së prodhuar nga KEK i dedikohet furnizimit të konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal përmes marrëveshjes së furnizimit me shumicë me furnizuesin universal, ku sipas nenit 5.2. të kësaj marrëveshjeje, KESCO mund të blejë energji elektrike nga KEK-u me prioritet, për qëllime të Furnizimit të konsumatorëve me të drejtën e Shërbimit Universal. Energjia e mbetur e prodhuar nga KEK-u ofrohet për OST dhe OSSH për të mbuluar humbjet në rrjet, në nivelet e transmetimit (KOSTT) dhe shpërndarjes (KEDS). Teprica e energjisë nga KEK-u tregtohet në treg të lirë sipas procedurës së tregtimit të energjisë elektrike. Kjo marrëveshje ndikon drejtpërdrejt në strukturën dhe funksionimin e tregut me shumicë, pasi kufizon sasinë e energjisë që mund të tregtohet në mënyrë konkurruese në treg.

Si rezultat, tregu me shumicë në Kosovë karakterizohet nga një nivel i kufizuar i likuiditetit dhe një varësi e konsiderueshme nga prodhimi vendor, ndërsa importet përdoren kryesisht për të mbuluar deficitin e prodhimit në periudhat e kërkesës së lartë ose gjatë ndërprerjeve të prodhimit.

Në vitin 2025, 89.22 % e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë është prodhuar nga KEK-u. Pjesa e mbetur e energjisë elektrike është prodhuar nga Parku i Erës Selaci (4.65 %), BRE në distribucion (2.43%), HC Lumbardhi (0.71%), Parku i Erës Kitka (1.71%), HC Ujmani (1.29%), e paraqitur në Figura 1.

Figura 1. Energjia elektrike e prodhuar në Kosovë në vitin 2025.



Që nga viti 2017, çmimet e prodhimit në Kosovë janë të de-rregulluara dhe caktohen përmes kontratave dypalëshe, dhe në vitin 2019 HC Ujmani filloi të ofrojë prodhimin e tij në treg përmes procedurave konkurruese.

Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë, si pjesë e skemës mbështetëse të zhvilluar nga ZRRE, trajtohet me prioritet në dispečim, dhe kompensohet nga të gjithë përdoruesit fundorë proporcionalisht në kuadër të tarifave të Operatorit të Tregut.

Gjatë vitit 2024 Kosova ka krijuar tregun një-ditë-para (day ahead) dhe në të njëjtën kohë është realizuar bashkimi i tregjeve (market coupling) me Shqipërinë, duke mundësuar një funksionim më efikas të tregut të energjisë elektrike dhe ka rritur likuiditetin, transparencën dhe konkurrencën. Gjithashtu, në fund të vitit 2024 është lansuar tregun brenda-ditor (intraday), duke mundësuar fleksibilitetin dhe reagimin ndaj ndryshimeve të menjëhershme të kërkesës dhe ofertës për energji elektrike.

Pavarësisht këtyre përparimeve, tregtimi i energjisë elektrike me shumicë vazhdon të kryhet kryesisht përmes kontratave bilaterale mes prodhuesve dhe furnizuesve (tregtarëve). Megjithatë, vetëm tepriçat e energjisë elektrike sipas marrëveshjes së furnizimit me shumicë, prodhimi i HC Ujmanit dhe energjia e prodhuar nga gjeneratorët BRE me skema mbështetëse janë tregtuar përmes ALPEX.

Marrëveshja e furnizimit me shumicë ndërmjet KEK dhe furnizuesit të shërbimit universal

Marrëveshja për furnizim me shumicë ndërmjet KEDS/KESCO dhe KEK-ut u nënshkrua si rezultat i transaksionit të privatizimit pas shthurjes së ndërmarrjes së integruar vertikalisht KEK në vitin 2012.


Sipas Marrëveshjes për furnizim me shumicë, KEDS/KESCO do të blejë energji elektrike nga KEK-u në baza jo ekskluziveve për të mbuluar nevojat e konsumit të saj.

Marrëveshja po ashtu thekson se KEK-u mund ta shesë energjinë elektrike të cilën nuk e kërkon KEDS/KESCO te blerësit e tjerë, por vetëm pasi kjo energji t'i ofrohet fillimisht KEDS/KESCO-s për furnizim me energji elektrike sipas kushteve të vendosura në marrëveshje.

Çmimet e prodhimit në Kosovë janë të de-rregulluara, gjë që do t'i mundësonte KEK-ut të ushtrojë fuqi të lartë në treg. Megjithatë, nuk është vërejtur ndonjë abuzim i tregut nga ana e KEK në lidhje me çmimet e energjisë së shitur sipas Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë. Çmimi me shumicë i energjisë elektrike të shitur nga KEK-u në vitin 2024 dhe 2025 për FSHU mbeti 29.5 €/MWh, dhe 36 €/MWh për të mbuluar humbjet në transmetim dhe shpërndarje. KEK-u në vitin 2025 ka eksportuar energji elektrike me çmim mesatar prej 92.69 €/MWh, derisa çmimi mesatar i importit në vitin 2025 në Kosovë ishte rreth 143.12 €/MWh.

Siç shihet në Figura 2, pjesa më e madhe e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK-u është e destinuar për KESCO-n, për konsumatorët e tij me të drejtën e furnizimit universal. Në vitin 2024, KEK-u ka shitur KESCO-s 81% të prodhimit neto të energjisë elektrike. Kjo përqindje është rritur në vitin 2025 në 85%. Pjesa tjetër e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK-u shitet për të mbuluar humbjet në shpërndarje (6.4% në 2025), humbjet në transmetim (0.8% në 2025) dhe pjesa e mbetur për eksport (7%).

Figura 2. Alokimi i prodhimit neto të energjisë elektrike të KEK-ut.




1.5. Llogaritja e indekseve për tregun me shumicë në Kosovë

Kapitulli në vijim paraqet llogaritjen e indekseve të përcaktuara në kapitullin 3, për tregun me shumicë në Kosovë. Indekset llogariten duke u bazuar në kapacitetet gjeneruese të cilat gjenden në territorin e Kosovës.

Përqindja e Tregut

Përqindja e tregut të prodhimit të energjisë elektrike, për nga vëllimi në Kosovë, është paraqitur në Figura 3.

Figura 3. Pjesëmarrja në treg për nga vëllimi i energjisë elektrike të prodhuar.



Gjenerimi i energjisë elektrike në Kosovë kryesisht është i dominuar nga KEK, me dy termocentralet Kosova A dhe Kosova B. Në vitin 2025 përqindja e prodhimit të energjisë nga KEK është rritur në 85.45%, dhe në vitin 2024 ka qenë 81.21% të tjera. Shkaku kryesor i rritjes është rënia e prodhimit nga BRE.


Analiza e përqindjes së tregut tregon se prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është shumë i përqendruar tek një numër i vogël prodhuesish, me një dominim të theksuar të prodhuesit kryesor. Ky nivel përqendrimi reflekton strukturën historike të sektorit energjetik dhe kapacitetet ekzistuese prodhuese në vend.

Megjithatë, në vitet e fundit është vërejtur një rritje graduale e pjesëmarrjes së prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, gjë që pritet të kontribuojë në uljen graduale të përqendrimit të tregut në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Indeksi HHI

Vlera HHI është kalkuluar duke u bazuar në përqindjet e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Siç shihet në fig 4, përqendrimi i tregut me shumicë mbetet shumë i lartë në Kosovë . Në vitin 2024, vlera HHI për tregun me shumicë ishte 8318, ndërsa 7993 për vitin 2025.

Figura 4. Vlera HHI për tregun me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë.



Ndryshimi i vlerave të HHI-së vie si rrjedhojë e rritjes së pjesës së përqindjes së prodhimit të energjisë nga KEK dhe zvogëlimit të pjesës së përqindjes nga prodhimi i BRE, si dhe anasjelltas.


Rezultatet e analizës së indeksit HHI konfirmojnë nivelin shumë të lartë të përqendrimit të tregut me shumicë në Kosovë. Vlerat e indeksit janë dukshëm mbi pragjet që në analizën ekonomike konsiderohen tregues të tregjeve shumë të përqendruara.

Ky rezultat tregon se struktura e tregut është e tillë që një numër shumë i kufizuar aktorësh kontrollojnë pjesën më të madhe të prodhimit të energjisë elektrike në vend. Në këto kushte, ekziston potenciali që prodhuesit dominant të ushtrojnë fuqi të konsiderueshme në treg, veçanërisht në periudhat kur kërkesa për energji elektrike është e lartë ose kur kapacitetet e tjera prodhuese janë të kufizuara.

Indeksi i Prodhuarit Pivotal (Pivotal Supplier Index – PSI)

PSI është llogaritur për KEK-un (Kosova A + Kosova B) dhe HC Ujmani, si dhe për TC Kosova A dhe TC Kosova B ndaras, për të analizuar fuqinë e tregut të secilit central veç e veç. Kapacitetet tjera gjeneruese si Kitka, Selaci dhe Lumbardhi, në pamundësi të prodhimit të kontrollueshëm, nuk mund të konsiderohen si Prodhuar Pivotal. PSI-ja është llogaritur për çdo orë për vitin 2024 dhe 2025 ndaras, të paraqitura në Figura 5.

Figura 5. Indeksi PSI për prodhuesit e energjisë elektrike në Kosovë.



Nga Figura 5, shihet se KEK-u është konsideruar si prodhues pivotal gjatë të gjitha orëve të vitit 2024 dhe 2025. Me fjalë të tjera, prodhimi nga KEK-u ishte i nevojshëm për të shmangur importin e energjisë elektrike në Kosovë në secilën orë të vitit, dhe teorikisht KEK-u mund të ushtronte fuqi në treg në 100% të rasteve, për të rritur çmimet e tyre deri në çmimet e importit.

Nga ana tjetër, HC Ujmani shihet si pivotal (i nevojshëm për shmangien e importit) në 57% të orëve në vitin 2024 dhe 79% të orëve në vitin 2025, edhe pse kishte një përqindje tregu prej vetëm 1.25% dhe 0.73% përkatësisht. HC Ujmani teorikisht mund të ushtronte fuqinë e tregut, dhe të vendoste çmime deri në çmimet e importit në këto orë. Për pjesën e mbetur të vitit, HC Ujmani nuk mund të ushtronte fuqi në treg dhe është marrës çmimi. TC Kosova B dhe TC Kosova A konsiderohen gjithashtu si prodhues pivotal në më shumë se 90% të kohës.

Indeksi i Furnizimit të Mbetur (Residual Supply Index – RSI)


Indeksi i Furnizimit të Mbetur (RSI) është llogaritur për çdo orë për KEK-un dhe HC Ujmani. Lakorja e kohëzgjatjes së RSI-së për të dy centralet është paraqitur në Figura 6.

Siç shihet në Figura 6, KEK-u ka një shkallë të lartë të fuqisë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit. Të gjithë prodhuesit e tjerë vendorë të kombinuar (përveç KEK-ut) mund të prodhonin më shumë se 20% të kërkesës totale vendore në vetëm 607 orë (7%) të vitit 2024, dhe vetëm gjatë 602 (7%) orëve të vitit 2025. Kështu, KEK-u ka një ndikim të rëndësishëm në çmimin mesatar të shitjes me shumicë të energjisë elektrike.

Derisa HC Ujmani ka mundur të zëvendësoj importin (indikatori PSI) në 54% të orëve të vitit 2024 dhe në 79% të orëve në vitin 2025, ndikimi i tij në çmimet e energjisë elektrike në këto kohë është i kufizuar për shkak të sasisë së ulët të prodhimit në krahasim me kërkesën totale. Kjo shihet nga Figura 6, ku

gjatë vitit 2025, gjeneratorët vendorë të tjerë mbuluan mbi 50% të kërkesës në 8315 orë të vitit, dhe mbi 100% të kërkesës gjatë 21% të orëve të vitit.

Figura 6. Indeksi RSI për KEK dhe HC Ujmani (2022 – 2025).



5. Vlerësimi i konkurrencës në tregun me pakicë të energjisë elektrike

5.1. Përshkrimi i tregut me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë

Në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, si dhe në përputhje me obligimet e Kosovës si Palë Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë për transpozimin dhe zbatimin e acquis të Komunitetit të Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) nga data 1 qershor 2025 ka vazhduar zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të Direktivës (BE) lidhur me procesin e hapjes së tregut të energjisë elektrike me pakicë, me qëllim që të sigurohet që të gjithë konsumatorët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla të kualifikuara të kenë të drejtë në furnizim me shërbim universal.

Në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, e drejta për furnizim me shërbim universal (FSHU) u takon vetëm konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve të vogla që punësojnë më pak se 50 persona dhe kanë qarkullim vjetor dhe/ose total të bilancit vjetor që nuk tejkalon 10 milionë euro. Konsumatorët që nuk i përmbushin këto kritere janë të obliguar të sigurojnë furnizimin me energji elektrike në kushte të tregut të hapur.


Në fillim të vitit 2025, ZRRE ka filluar një fushatë gjithëpërfshirëse informuese për konsumatorët që nuk janë të kualifikueshëm për shërbimin universal. Vazhdimi i këtij procesi kishte për qëllim informimin e këtyre konsumatorëve lidhur me afatet përkatëse, kërkesat rregullative dhe procedurat për kalimin në furnizim në tregun e hapur të energjisë elektrike. Në këtë kuadër, ZRRE ka organizuar dhe ka marrë pjesë në disa takime dhe punëtori me përfaqësues të konsumatorëve, përfshirë Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike Gjermane, Aleancën Kosovare të Bizneseve si dhe odat tjera që operojnë në Kosovë, si dhe palë të tjera kyçe të sektorit të energjisë.

Paralelisht, operatorët e sistemit KEDS dhe KESCO si furnizues me obligimin e shërbimit universal, kanë identifikuar konsumatorët që nuk janë të kualifikueshëm për furnizim me shërbim universal

(konsumatorët e de rregulluar) dhe kanë ndërmarrë masat e nevojshme teknike, operacionale dhe komerciale për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre efektive në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Siç paraqitet në Figurën 7, sasia e energjisë së furnizuar në tregun e lirë përbënte 11% të furnizimit total me energji në vitin 2025, krahasuar me 4% në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 7 pikë përqindje

Figura 7. Sasitë e energjisë të furnizuara në treg të lirë dhe në tregun e rregulluar.



Në tregun me pakicë në Kosovë janë të licencuar 30 furnizues, ku 9 prej tyre janë aktiv në treg, përfshirë edhe Furnizuesin me shërbim universal.

Duhet potencuar se ZRRE ka të hartuar dhe miratuar tërë kornizën rregullative lidhur me procesin e hapjes së tregut të energjisë elektrike, si Rregulla për Ndërrimin e Furnizuesit, Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal, Rregulla për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, etj.

Duhet të theksohet se të gjithë konsumatorët, pa përjashtim, kanë të drejtën të furnizohen në tregun e derregulluar. Gjatë vitit 2025, nga numri i përgjithshëm i konsumatorëve të regjistruar, 35,040 konsumatorë i nënshtrohen çmimeve të derregulluara.

Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Përveç Furnizuesit Universal, i cili siguron energji për konsumatorët të cilët nuk janë të obliguar dhe nuk dëshirojnë të hyjnë në treg, ZRRE-ja sipas nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike, përcakton Furnizuesin e Mundësisë së Fundit. Sipas nenit 9.1 të Rregullës së ZRRE-së nr. 08/2017 për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) do të furnizojë konsumatorët që mbeten pa furnizues në rrethanat e mëposhtme:

1. Furnizuesi i tyre ka falimentuar ose është në likuidim.

2. Licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përgjithmonë ose përkohësisht ose ka pushuar së qeni e vlefshme (ka skaduar).
3. Konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e një furnizuesi të ri pas përfundimit të kontratës me atë të mëparshëm.

Furnizuesi i mundësisë së fundit zgjidhet përmes një skeme konkurruese. Metodologjia e çmimeve dhe marzhat me pakicë të propozuara nga FMF-ja janë rishikuar nga ZRRE. Çmimi i energjisë elektrike i FMF-së duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut për të nxitur konsumatorët të gjejnë furnizues alternativë. Deri më 31 korrik 2022, KESCO ishte caktuar si Furnizues i Mundësisë së Fundit. Në bazë të Vendimit V_1544_2022, nga data 31 korrik 2022 deri më 30 korrik 2025, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me licencë të furnizimit, është caktuar të ushtrojë përgjegjësitë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Pas përfundimit të kësaj periudhe, përmes vendimit V_2762_2025 të datës 12 qershor 2025 të ZRRE-së, ky funksion i është vazhduar KEK-ut për një periudhë të përkohshme prej gjashtë (6) muajsh, deri më 30 janar 2026, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së furnizimit. Më pas, me vendimin V_3015_2026 të datës 02 shkurt 2026, KEK është caktuar të vazhdojë të ushtrojë funksionin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për një periudhë të re prej tre (3) vitesh.

5.2. Llogaritja e indekseve për tregun me pakicë në Kosovë

Kapitulli në vijim paraqet llogaritjen e indekseve të përcaktuara në kapitullin 3, për tregun me pakicë në Kosovë. Indekset llogariten duke u bazuar në sasinë e furnizuara të energjisë nga furnizuesit e licencuar në Kosovë.

Pjesëmarrja në treg dhe indeksi HHI

Gjatë vitit 2025, në treg kanë operuar tetë furnizues aktivë, krahasuar me vetëm katër furnizues në vitin 2024, çka reflekton një rritje të numrit të pjesëmarrësve në treg. Pavarësisht këtij zhvillimi në numrin e furnizuesve, tregu i lirë mbetet i karakterizuar nga një nivel i kufizuar i konkurrencës. Tabela 1 paraqet shpërndarjen e përqindjes së furnizimit me energji elektrike në tregun me pakicë ndërmjet furnizuesve aktivë gjatë viteve 2024 dhe 2025, duke reflektuar strukturën reale të tregut sipas volumit të energjisë së furnizuar.

Të dhënat tregojnë se KESCO vazhdon të mbajë pozitë dominuese në treg. Në vitin 2025, pjesëmarrja e tij arrin rreth 93% të furnizimit total, ndërsa edhe në vitin 2024 pjesëmarrja ka qenë në nivele të ngjashme. Kjo nënkupton se 7% e tregut ndahet ndërmjet të gjithë furnizuesve të tjerë aktivë së bashku.

Nga pikëpamja strukturore, edhe pse numri i furnizuesve aktivë është rritur nga katër në vitin 2024 në tetë në vitin 2025, kjo rritje nuk është reflektuar në një rishpërndarje të ndjeshme të pjesëmarrjes në treg. Furnizuesit operojnë me pjesë individuale shumë të vogla, të cilat nuk krijojnë presion të konsiderueshëm konkurrues ndaj furnizuesit dominues.

Tabela 1. Përqindja e furnizimit të energjisë në treg nga furnizuesit aktiv gjatë vitit 2024 dhe 2025.


Kompanitë Aktive	2024			2025		
	Përqindja e tregut të rregulluar	Përqindja e tregut të lirë	Përqindja e tregut të gjithëmbarshëm	Përqindja e tregut të rregulluar	Përqindja e tregut të lirë	Përqindja e tregut të gjithëmbarshëm
KESCO FSHU	100.0%	0.0%	95.86%	100.0%	0.0%	89.4%
KESCO Parregulluar	0.0%	1.1%	0.04%	0.0%	33.9%	3.6%
GSA Energji	0.0%	3.4%	0.14%	0.0%	0.0%	0.0%
FUENTE	0.0%	0.0%	0.00%	0.0%	0.0%	0.0%
KEK	0.0%	1.1%	0.05%	0.0%	19.4%	2.1%
Elektroserver	0.0%	94.4%	3.91%	0.0%	32.9%	3.5%
Enerco	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	3.1%	0.3%
EDS International KS	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	2.7%	0.3%
Voltkos	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	8.0%	0.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Rrjedhimisht indeksi HHI për tregun me pakicë për konsumatorët familjar është 10,000 për vitin 2024 dhe 2025 që paraqet një treg monopolist.

Figura 4 paraqet indeksin HHI për tregun e gjithëmbarshëm me pakicë, dhe segmentin e tregut të lirë me pakicë. Tregu i gjithëmbarshëm me pakicë karakterizohet me një nivel të lartë koncentrimi gjatë viteve 2024 dhe 2025. Vlerat e indeksit HHI për tregun e gjithëmbarshëm me pakicë janë 9,212 në vitin 2024 dhe 8,743 në vitin 2025. Vlerat janë dukshëm mbi pragun prej 2,500 pikësh, i cili sipas standardeve konsiderohet si treg shumë i përqendruar.

Sa i përket segmentit të tregut të lirë me pakicë, vlerat e HHI janë 8,930 në vitin 2024 dhe 2,687 në vitin 2025. Vazhdimi i procesit të liberalizimit të tregut me pakicë gjatë vitit 2025, ka bërë që indeksi HHI të ketë një ulje të konsiderueshme, megjithatë niveli i përqendrimit mbetet mbi pragun që konsiderohet si treg me konkurrencë të lartë, pasi që ky segment përfaqëson një pjesë relativisht të vogël të tregut të gjithëmbarshëm me pakicë.

Figura 4. Indeksi HHI për tregun e lirë me pakicë dhe tregun e gjithmbarshëm me pakicë.



Tregu me pakicë i energjisë elektrike në Kosovë gjatë vitit 2025 ka kaluar një proces gradual liberalizimi, i cili synon të krijojë kushte për konkurrencë ndërmjet furnizuesve dhe për zgjedhje më të madhe për konsumatorët.

Megjithatë, analiza e strukturës së tregut tregon se konkurrenca në këtë segment mbetet e kufizuar, për arsye se në treg të derregulluar kanë dalur vetëm konsumatorët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e shërbimit universal. Edhe pse një numër relativisht i madh furnizuesish janë të licencuar për të operuar në treg gjatë vitit 2025, vetëm një pjesë e tyre janë aktiv në praktikë, respektivisht 8 furnizues janë aktivizuar dhe kanë dhënë oferta me çmime të derregulluara.

Dominimi i furnizuesit universal në furnizimin e konsumatorëve familjarë dhe ndërmarrjeve të vogla, së bashku me pjesëmarrjen relativisht të ulët të konsumatorëve në tregun e lirë, kanë bërë që pjesa më e madhe e tregut me pakicë të mbetet shumë e përqendruar.

6. Përfundime

Tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë në Kosovë i është nënshtruar reformave gjatë dy dekadave të fundit. Kosova ka kaluar nga një treg i integruar vertikalisht në pronësi të shtetit, duke filluar me krijimin e rregullatorit të pavarur, shthurjen e kompanisë së integruar vertikalisht KEK duke krijuar kompani të veçanta për prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim. Kompanitë që operojnë në tregjet me monopole natyrore, si transmetimi dhe shpërndarja do të vazhdojnë të mbikëqyren nga ZRRE.

Bazuar në legjislacionin primar, është bërë vlerësimi i konkurrencës për shitje me shumicë dhe pakicë. Vlerësimi bazohet në llogaritjen e indekseve të përqendrimit të tregut, të tilla si përqindja e tregut

(MS), raporti i përqendrimit, indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI), Indeksi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Residual (RSI).

Bazuar në analizën, përfundimet janë:

- Tregu me shumicë është shumë i përqendruar me një përqindje tregut të prodhuesit më të madh (KEK) prej 90.45% në 2024 dhe 89.2% në 2025. Indeksi HHI për 2024 dhe 2025 është përkatësisht 8318 dhe 7993, dhe paraqet një treg shumë të përqendruar.
- Sipas indekseve PSI dhe RSI, KEK mund të ushtrojë fuqi të lartë në treg gjatë të gjitha orëve të vitit dhe mund të rrisë çmimet deri në çmimet e importit në çdo kohë të caktuar, derisa HC Ujmani mund të ushtrojë fuqi të kufizuar në treg gjatë 57% të orëve të vitit në vitin 2024 dhe 79% të orëve në vitin 2025.
- KESCO në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) furnizon një numër të madh konsumatorësh që plotësojnë kriteret për këtë shërbim, ndërsa vetëm një pjesë relativisht e vogël e konsumatorëve që nuk i plotësojnë këto kriteret ka kaluar në tregun e hapur, rezulton se struktura e tregut mbetet ende e përqendruar në nivel të lartë.
- Pjesa më e madhe e konsumatorëve vazhdon të furnizohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (KESCO), në bazë të obligimit të shërbimit publik të vendosur nga ZRRE, i cili mbulon konsumatorët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla që plotësojnë kriteret ligjore për furnizim në kuadër të shërbimit universal.
- Obligimi për Furnizuesin e Shërbimeve Publike i është vendosur KESCO-s nga ZRRE. Obligimi i furnizuesit të mundësisë së fundit i është vendosur KEK nga ZRRE, pas një procedure konkurruese të dështuar për shkak të mos aplikimit të furnizuesve.
- Konsumatorëve të pa rregulluar u janë ofruar çmime të bazuara drejtpërdrejt me çmimet e importit, gjë që shkaktoi hezitim të daljes nga sektori i rregulluar në treg të lirë.
- Për periudhën e shqyrtimit, bazuar në treguesit e analizuar, tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë shfaq mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë.

Treguesit e analizuar të strukturës së tregut tregojnë se tregu i furnizimit me energji elektrike në Kosovë karakterizohet nga një nivel shumë i lartë i përqendrimit. Pjesa dominuese e tregut zotërohet nga një furnizues i vetëm, ndërsa pjesëmarrja e furnizuesve të tjerë mbetet shumë e kufizuar. Ky nivel i lartë i përqendrimit tregon mungesë të konkurrencës efektive në tregun me pakicë dhe kufizon mundësinë e konsumatorëve për të përfituar nga alternativa të ndryshme të furnizimit.

Edhe pse ka vazhduar procesi i liberalizimit të tregut me pakicë të energjisë elektrike, segmenti i tregut të lirë mbetet relativisht i vogël në krahasim me tregun e përgjithshëm me pakicë, rrjedhimisht pjesa më e madhe e konsumatorëve familjar dhe ndërmarrjeve të vogla vazhdojnë të furnizohen në kuadër të shërbimit universal.

Në këto rrethana, ndërhyrja rregullatore konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe për të siguruar stabilitet në furnizim. Për këtë arsye, ZRRE-ja vazhdon të rregullojë çmimet për Furnizuesin me Shërbim Universal. Rregullimi i çmimeve në këtë segment synon të sigurojë që konsumatorët që furnizohen në kuadër të shërbimit universal të kenë qasje në energji elektrike me çmime të arsyeshme dhe transparente, në një treg ku konkurrenca ende nuk është zhvilluar në nivel të mjaftueshëm.

Në të njëjtën kohë, ky mekanizëm rregullator synon të krijojë kushte për zhvillimin gradual të konkurrencës në treg, duke ruajtur një balancë ndërmjet mbrojtjes së konsumatorëve dhe nxitjes së pjesëmarrjes së furnizuesve të rinj në treg.

Shtojca 1. Ndikimi i bashkimit të tregut me Shqipërinë në konkurrencën e tregut me shumicë të energjisë elektrike

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a u krijua si shoqëri aksionare në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST SH.A) dhe Kosovës (KOSTT SH.A).

Më 21 tetor 2021, ERE, ZRRE, OST dhe KOSTT nënshkruan Marrëveshjen kuadër për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, duke njohur ALPEX si të vetmen bursë energjetike për tregun një ditë para (DAM) dhe tregun brenda ditës (IDM) në Kosovë.

Më 16.12.2022, KOSTT dhe ALPEX – Dega në Kosovë nënshkruan Marrëveshjen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut brenda ditës dhe kalkulimet e barazimeve përfundimtare. Kjo marrëveshje u miratua nga ZRRE me Vendimin nr. V_1637_2022, datë 27.12.2022.


Bordi i ZRRE-së, me Vendimin nr. V_1638_2022, datë 27.12.2022, miratoi Rregullat e ALPEX-it, dhe më pas, me Vendimin nr. V_2586_2024, datë 06.12.2024, miratoi ndryshimet e propozuara nga ALPEX.

ALPEX u emërua si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për zonën e Shqipërisë dhe Kosovës, përmes:


1. Vendimit të Bordit të ERE nr. 228, datë 17.07.2023;
2. Vendimit të Bordit të ZRRE V_1748_2023, datë 17.07.2023.

Një treg i përbashkët me Shqipërinë, ku e gjithë energjia elektrike shitet përmes bursës së përbashkët të energjisë, do të zvogëlonte gjithashtu përqendrimin e tregut në tregun me shumicë për Kosovën, si dhe për Shqipërinë.

Për bashkimin e tregut Kosovë - Shqipëri, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 2,811,090.48 MWh krahasuar me 1,534,425.97 MWh në vitin 2024, ndërkohë oferta në shitje për vitin 2025 ishte 2,719,930.84 krahasuar me 1,868,626.34 MWh në vitin 2024 e paraqitur me grafikun në vijim.



Pozicioni i tregut të Kosovës në këtë bashkim tregu për vitin 2025 ka qenë eksportues në total volume 141,373.92 MWh kundrejt 209,779.02 MWh si importues, kjo e ilustruar me grafikun në vijim.




Për bashkimin e tregut Kosovë - Shqipëri, rrjedhja totale e energjisë (në të dy drejtimet) për vitin 2025 ishte 351,152.95 MWh krahasuar me 268,914.23 MWh në vitin 2024.

Duke u bazuar në prodhimin e energjisë në Shqipëri dhe Kosovës gjatë vitit 2025, mund të bëhet një analizë e përafërt e koncentrimin të një tregu të përbashkët ku e gjithë energjia e prodhuar në Kosovë dhe Shqipëri tregtohet përmes Bursës ALPEX.

Në Figura 5, paraqitet përqindja e tregut për prodhuesit në Kosovë dhe Shqipëri. Këtu vërehet që edhe brenda një tregu tërësisht të integruar dhe të përbashkët, kompanitë më të mëdha prodhuese KEK dhe KESH do të kishin pozitë dominante në treg, ku KEK do të prodhonte nga 45.17% të prodhimit dhe KESH 35.14% të gjithmbarshëm. Prodhuesit tjerë së bashku do të prodhonin 20% të energjisë.

Figura 5. Përqindja e tregut me shumicë e prodhuesve më të mëdhenj në Kosovë dhe Shqipëri.



Në bazë të përqindjeve të tregut nga prodhuesit në tregun e përbashkët mund të llogaritet edhe indeksi HHI, i cili rezulton të jetë 3287. Ky indeks pasqyron një treg me koncentrim shumë të lartë.

Bordi, në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2026, ka shqyrtuar dhe miratuar dokumentin Vlerësimi i Konkurrencës në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë 2024-2025.

Me këtë miratim, dokumenti publikohet dhe shpërndahet tek palët e interesuara , duke përmbushur rritjen e transparencës dhe informimit mbi ecurinë e tregut të energjisë.